

**DITA NDËRKOMBËTARE PËR NDËRGJEGJËSIMIN MBI
ABUZIMIN ME TË MOSHUARIT 15 QERSHOR 2019**

NGRINI ZËRIN TUAJ.

**NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT**



**15 QERSHOR DITA NDËRKOMBËTARE e
NDËRGJEGJËSIMIT NDAJ ABUZIMIT ME TË
MOSHUARIT**

ABUZIMI TË MOSHUARVE: ÇESHTJE E TË GJITHËVE

Dita Botërore e Ndërgjegjësimit mbi Abuzimin e të Moshuarve mbahet më 15 qershor 2019 dhe është një ditë vjetore ndërkombëtare e caktuar nga Kombet e Bashkuara në të njëjtën datë çdo vit. Dita u njoh zyrtarisht nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në dhjetor 2011 me rezolutën e OKB-së 66/127 për Ndërgjegjësimin Botëror ndaj Abuzimit mbi të moshuarit, pas një kërkesë të Rrjetit Ndërkombëtar për Parandalimin e Abuzimit të të Moshuarve (INPEA), i cili së pari zhvilloi këtë temë në qershor 2006. Ajo përfaqëson një ditë në vit kur e gjithë bota ndërgjegjësohet dhe kundërshton ndaj abuzimeve dhe vuajtjeve të shkaktuara disa prej gjeneratave tona më të vjetra.



NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Abuzimi i të moshuarve është një çështje sociale globale që ndikon në shëndetin dhe të drejtat e njeriut të miliona personave të moshuar në mbarë botën dhe një çështje që meriton vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare.

Me një rritje të popullsisë globale të të moshuarve dhe rritjes së jetëgjatësisë, abuzimi i të moshuarve është një problem gjithnjë në rritje dhe serioz që ndikon në shëndetin dhe të drejtat e njeriut dhe mund të shkaktojë vdekjen, prandaj është jetësore ta rrisim vetëdijen dhe kështu ta parandalojmë sa herë që dhe kudo që të jetë e mundur.

OKB-ja synon të rrisë ndërgjegjësimin për abuzimet ndaj të moshuarve dhe ta parandalojë atë

Abuzimi i të moshuarve është global dhe vjen në shumë forma, duke përfshirë abuzimin fizik, emocional, seksual dhe financiar dhe gjithashtu neglizhimi. Njerëzit e moshuar meritojnë të njëjtin dinjitet dhe respekt si njerëzit e të gjitha grupmoshave të tjera.

Njerëzit e moshuar janë veçanërisht të pambrojtur ndaj abuzimit dhe të paaftë për t'u mbrojtur kërkuar ndihmë, pasi frika dhe dobësia mund të jenë barriera të mëdha për të kërkuar dhe marrë ndihmë.

Nganjëherë të vërejmë dhe sfidojmë abuzimin në të moshuarit nuk është e lehtë, disa janë të izoluar pasi kanë jetuar pa familje dhe miq dhe disa keqpërdoren në institucione ku abuzimi nuk shikohet, ose është i mbuluar dhe në disa raste të moshuarve nuk u jepet përparësi nga autoritetet në çështjet e abuzimit.



NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

“Ngritja e zërave” për Ditën e Ndërgjegjësimit Botëror për abuzimin ndaj të moshuarve, është tema e vitit 2019 që përqendrohet në unifikimin e vlerave të përbashkëta të drejtësisë ndaj të moshuarve dhe reagimin ndaj dhunës për të treguar përvojat jetësore të njerëzve të moshuar anekënd globit.



Pothuajse të gjitha vendet pritet të shohin rritje të ndjeshme të numrit të personave të moshuar ndërmjet viteve 2015 dhe 2030 dhe kjo rritje do të jetë më e shpejtë në vendet në zhvillim. Në vitin 2050 rreth 80% e njerëzve të moshuar do të jetojnë në vendet më pak të zhvilluara. Moshimi i popullsisë po ndodh paralelisht me urbanizimin e shpejtë; nga viti 2007 më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton në qytete dhe në vitin 2030 kjo shifër pritet të rritet në më shumë se 60%.

Për shkak se numri i personave të moshuar po rritet, shifra e abuzimit ndaj të moshuarve pritet të rritet me të.

Në shumë pjesë të botës abuzimi ndaj të moshuarve, ky problem serioz social deri kohët e fundit u fsheh nga publiku dhe konsiderohej kryesisht si çështje private. Edhe sot, abuzimi ndaj të moshuarit vazhdon të jetë një tabu, kryesisht i nënvlerësuar dhe injoruar nga shoqëritë anëmbanë botës. Megjithatë, dëshmi po grumbullohen, për të treguar se abuzimi ndaj të moshuarve është një problem i rëndësishëm publik dhe shoqëror

Ndërsa tema tabu e abuzimit të të moshuarve ka filluar të fitojë shikueshmëri në të gjithë botën, ajo mbetet një nga llojet më të pakta të hetuara të dhunës në sondazhet kombëtare dhe një nga më pak të adresuarat në planet kombëtare të veprimit.

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Abuzimi i të moshuarve sipas OBSH mund të përkufizohet si *"një veprim i vetëm, ose i përsëritur, ose mungesa e veprimit të duhur, që ndodh brenda çdo marrëdhënieje ku ka një shpresë besimi që shkakton dëm, ose shqetësim për një person të moshuar"*.



Plakja e popullsisë është një triumf i shoqërisë moderne. Ajo pasqyron përmirësimin e shëndetit global, por edhe ngre sfida të veçanta për shekullin e 21-të në të gjitha vendet, si ato në zhvillim dhe ato të zhvilluara..

Jetëgjatësia është duke u rritur edhe në vendet në zhvillim, por ka dallime të mëdha ndërmjet vendeve. Për shembull, ndërsa Japonia ka jetëgjatësinë më të lartë në botë me 82.2 vjet, në disa vende si Afrika kjo shifër është 40 vjet më e ulët.

Brënda vendeve, pabarazitë në shëndet janë gjithashtu të rëndësishme. Njerëzit e grupeve me shtresë të lartë social-ekonomike mund të jetojnë deri në 20 vjet më gjatë se njerëzit e grupeve me të ardhura të ulëta social-ekonomike.

Deri në vitin 2050, afër 80% e të gjitha vdekjeve pritet të ndodhin në njerëzit mbi 60 vjeç. Shpenzimet shëndetësore rriten me moshën dhe janë të përqendruara në dy vitet e fundit të jetës, pavarësisht se sa i vjetër është dikush.

Ndërsa njerëzit jetojnë më gjatë, është e rëndësishme tu sigurohet këtyre viteve shtesë shëndet, në mënyrë që shpenzimet e kujdesit shëndetësor të mund të menaxhohen.

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Shumica e të moshuarve vdesin nga sëmundjet kronike jo të transmetueshme. Edhe në vendet e varfra tashmë shumica e të moshuarve vdesin nga sëmundje kronike jo të transmetueshme si sëmundja e zembrës, kanceri e diabeti

Investimi në shëndet gjatë gjithë jetës prodhon vlera për shoqërinë. Njerëzit e moshuar të shëndetshëm janë mbështetje për familjet e tyre, komunitetet dhe ekonominë. Asnjëherë nuk është shumë vonë për të ndryshuar sjelljet e rrezikshme dhe për të promovuar shëndetin; për shembull, rreziku i vdekjes së parakohshme ulet me 50 % nëse dikush heq dorë nga pirja e duhanit mes moshës 60 dhe 75 vjeç.

Nevoja e një kujdesi afatgjatë po shtohet. Në vendet e zhvilluara, numri i të moshuarve të cilët nuk janë më në gjendje të kujdesen për veten pritet të katërfishohet në vitin 2050. Një numër i madh personash shumë të moshuar humbasin aftësinë për të jetuar të pavarur për shkak të paaftësisë për të lëvizur, dobësisë, apo problemeve të tjera fizike, apo mendore lidhur me moshën.

Shumë prej tyre kërkojnë kujdes afatgjatë, ku mund të përfshijmë nevojën e një infermiereje në shtëpi, ndihmën nga të afërmit, apo shtrime të gjata në spitale.

Kujdesi shëndetësor parësor efektiv, në nivel komuniteti, për të moshuarit është shumë i rëndësishëm për promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike.

Në të moshuarit rritet rreziku i rrëzimeve dhe lëndimet janë shumë më serioze. Kjo çon në rritje të kostove shëndetësore, njerëzore edhe ekonomike.

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Abuzimi me të moshuarit rritet me plakjen e popullsisë dhe dinamikën e ndryshimeve sociale. OBSH-ja vlerëson se 4-6% e personave të moshuar në mbarë botën vuajnë nga një formë e abuzimi si fizik, psikologjik, emocional, financiar, ose për shkak të lënies pas dore (neglizhimit).

Roli i të moshuarve nuk është i rëndësishëm vetëm në vendet në zhvillim por edhe në vendet e zhvilluara. Në Spanjë për shembull, kujdesi për personat në varësi dhe ata të sëmurë (të gjitha moshave), kryhet kryesisht nga njerëz të moshuar (veçanërisht gra të moshuara). Numri mesatar i minutave të shpenzuara në ditë për një kujdes të tillë rritet me rritjen e moshës së kujdestarit; nëse kujdestari është i grupmoshës 65-74 vjeç ai shpenzon 201 minuta, nëse është 75-84 vjeç shpenzon 318 minuta, krahasuar me grupmoshën 30-49 që shpenzon vetëm 50 minuta.



NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

FAKTE DHE SHIFRA

- Globalisht, popullsia po plakët me shpejtësi. Mes viteve 2015 dhe 2050, përqindja e popullsisë së botës mbi 60 vjet do të jetë gati dyfish, nga 12% në 22%.
- Është parashikuar që deri në vitin 2050, popullsia globale e njerëzve të moshës 60 vjeç e lart do të jetë më shumë se dyfishi, nga 900 milionë në vitin 2015 në rreth 2 miliardë, me shumicën dërrmuese të njerëzve të moshuar që jetojnë në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.
- Rreth 1 në 6 persona të moshuar përjetojnë një formë abuzimi, një shifër më e lartë se sa vlerësohet më parë dhe parashikohet të rritet pasi popullsia është duke u plakur në mbarë botën.
- Nëse përqindja e viktimave të abuzimit me të moshuarit mbetet konstante, numri i viktimave do të rritet me shpejtësi për shkak të plakjes së popullsisë, duke arritur në 320 milionë viktima deri në vitin 2050.
- Çrregullimet mendore dhe neurologjike të moshuarve llogariten 6.6% të totalit të aftësisë së kufizuar (DALYs) për këtë grupmoshë.
- Përafërsisht 15% e të rriturve të moshës mbi 60 vjeç vuajnë nga një çrregullim mendor.
- Shkalla e abuzimit mund të jetë më e lartë për të moshuarit që jetojnë në institucione sesa në komunitet.
- Abuzimi i të moshuarve mund të çojë në plagosje të rënda fizike dhe pasoja afatgjata psikologjike.

NGRINI ZËRIN TUAJ.
NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT



Abuzimi i të moshuarve është një problem i rëndësishëm për shëndetin publik. Një studim i vitit 2017 i kryer nga OBSH, bazuar në evidencën më të mirë të disponueshme nga 52 studime në 28 vende nga rajone të ndryshme, duke përfshirë 12 vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme, vlerësoi se gjatë vitit 2016, 15.7% e njerëzve të moshës 60 vjeç e lart iu nënshtruan disa formave të abuzimit.

Kjo ka të ngjarë të jetë një nënvlerësim, pasi vetëm 1 në 24 raste të abuzimit me të moshuarit është raportuar, pjesërisht për shkak se njerëzit e moshuar shpesh kanë frikë të raportojnë raste abuzimi me familjen, miqtë, apo autoritetet. Rrjedhimisht, çdo përqindje e përhapjes së abuzimit ka të ngjarë të nënvlerësohet.

Megjithëse të dhënat janë të kufizuara, studimi ofron vlerësime të prevalencës së numrit të personave të moshuar të prekur nga lloje të ndryshme abuzimi:

abuzimi psikologjik:	11.6%
abuzimi financiar:	6.8%
neglizhimi:	4.2%
abuzimi fizik:	2.6%
abuzimi seksual:	0.9%

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Të dhënat mbi shtrirjen e problemit në institucione të tilla si spitalet, shtëpitë e pleqve dhe objektet e tjera të kujdesit afatgjatë janë të pakta. Sidoqoftë, rishikimet sistematike dhe meta-analizat e studimeve të kohëve të fundit mbi abuzimin me të moshuar në institucionet dhe në komunitetin bazuar në vetë-raportimin e të rriturve të moshuar sugjerojnë se shkalla e abuzimit është shumë më e lartë në institucione kujdesi për këto persona sesa në mjediset e komunitetit.



Studimi OBSH tregoi përlllogaritjet e abuzimit moshuarve dhe nëntipit të tij në institucione të mbledhura në një total prej 9 studimesh në 6 vende, bazuar në vetë-raportet e stafit për kryerjen e abuzimit, ishin. Rreth 64.2% e stafit kanë kryer një formë abuzimi gjatë vitit të kaluar. Vlerat e vetë-raportuara për nëntipet e abuzimit të moshuarve nga stafi dhe banorët e moshuar sugjerojnë ngjashmëri në madhësinë e problemit.

Abuzimi të moshuarve mund të çojë në plagosje fizike - duke filluar nga gërvishtjet e vogla, nga plagët deri te eshtrat e thyera dhe lëndimet e paaftësitë - dhe pasojat serioze, ndonjëherë të zgjatura psikologjike, duke përfshirë depresionin dhe ankthin.

Për njerëzit e moshuar, pasojat e abuzimit mund të jenë veçanërisht serioze dhe më të zgjatura në kohë. Edhe dëmtimet relativisht të vogla mund të shkaktojnë dëme serioze dhe të përhershme, madje edhe vdekje. Një studim 13-vjeçar përcaktoi se viktimat e abuzimit të moshuarve kanë dy herë më shumë gjasa të vdesin para kohe se sa njerëzit që nuk janë viktimat të abuzimit të moshuarve

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Çfarë është abuzimi me të moshuarit

Abuzimi i të moshuarve i referohet akteve të qëllimshme ose neglizhente nga një kujdestar, ose një individ i besuar që i shkakton dëm një personi të moshuar.

Abuzimi i të moshuarve merr shumë forma, duke përfshirë:

- abuzimin fizik
- abuzimin emocional, ose psikologjik
- abuzimin seksual
- abuzimin financiar dhe shfrytëzimin
- neglizhimin ose izolimin



Çfarë është abuzimi i të moshuarve?

Është abuzimi dhe neglizhimi i të moshuarve. Ai ka disa forma.



Abuzimi fizik



Abuzimi psikologjik
dhe emocional



Abuzimi seksual



Shfrytëzimi financiar



Neglizhimi ose braktisja

**DITA NDËRKOMBËTARE PËR NDËRGJEGJËSIMIN MBI
ABUZIMIN ME TË MOSHUARIT 15 QERSHOR 2019**

NGRINI ZËRIN TUAJ.

**NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT**

Tb. Llojet e abuzimit me të moshuarit

Llojet e abuzimit	Karakteristikat	Shembuj
Financiar ose material	Përdorimi i paligjshëm, ose i padrejtë i fondeve, ose burimeve, shfrytëzimi	Vjedhja e kartave të debitit, ose të kreditit, shtrëngimi për të privuar personin më të vjetër nga pasuria (p.sh., transferimi dhe martja me forcë i pronës, ose llogarive).
Neglizhimi ose braktisja	Refuzimi i qëllimshëm, ose i pavullneshëm i dështimit të kujdestarit të caktuar për të plotësuar nevojat e kërkuara për mirëqenien e një personi të moshuar	Dështimi për të siguruar ushqim, veshmbathje, strehim, kujdes mjekësor, higjienë, ose stimulim / ndërveprim social.
Fizik	Shkaktimi dhimbjes, dëmtimi	Shuplaka, goditja, grushtimi, pickimi, kufizimi me forcë i ushqimit, goditja me objekte.
Psikologjik ose emocional	Shkaktimi i ankthit mendor	Agresion verbal, ose kërcënim, kërcënime të dërgimit në institucione për të moshuarit, izolim social, deklarata poshtëruese.
Seksual	Kontakt genital jo seksual, e bisedë seksuale e padëshiruar	Biseda rreth seksit aktiviteti seksual i detyruar, prekja, përkëdhelja e një personi të aftë, ose paaftë

Shenjat paralajmëruese të abuzimit ndaj të moshuarve

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Shenjat e abuzimit me të moshuarit mund të jenë të vështira për t'u njohur ose mund të ngatërrohen me simptomat e demencës ose dobësinë e personit të moshuar - ose kujdestarët mund t'i shpjegojnë ato në atë mënyrë.

Argumentet e shpeshta ose tensionet midis kujdestarit dhe personit të moshuar, ose ndryshimet në personalitetin, ose sjelljen e të moshuarve mund të jenë sinjale të gjera të abuzimit të pleqve.

Shenjat e abuzimit me të moshuarit

- Mavijosje në vende të pazakonta (jo mbi daljet kockore, mbi krahët anësore, fytyrëose shpinë, më të mëdha se 5 cm) veçanërisht në se ato shfaqen simetrike në të dyja anët e trupit
- Djegje në modelet që nuk perputhen me lëndim të paqëllimshëm, ose me shpjegimin e dhënë (p.sh., modeli si çorape ose dorezë, që sugjeron zhytje të detyruar)
- Lëndimet e modeluara si shenja shuplakës, ose shenjat e kafshimit; shënja lidhje përreth kyçit, ose plagë rreth nyjeve, këmbëve, ose qafës duke sugjeruar kufizime të papërshtatshme të personit
- Ulçerë Dekubitusi, përveç nëse është rezultat i rënies së pashmangshme
- Dehidratim, konstipacion
- Plagë intraorale të indeve të buta
- Kequshqyerja, humbje peshe e pashpjegueshme nga ana mjekësore
- Medikamente që mungojnë
- Syze të thyera
- Kontrolli i dobët i problemeve mjekësore përkundër një plani të arsyeshëm mjekësor dhe qasjes në ilaçe
- Hemorragjia nënkonzjunktive ose okulare okulte
- Alopecia traumatike, ose ënjtje e kokës
- Fraktura të pashpjegueshme
- Vonesa e pazakontë në kërkimin e kujdesit mjekësor për lëndimet

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË MOSHUARIT

- Djegiet e urinës (të ngjashme me skuqjen e të pelenave), veshja e ndotur, ose shenja të tjera të moskujdesit ndaj higjienës.
- Kushtet e jetesës joadekuate,,: papastërtitë, mizat, mbulesat dhe rrobat e ndotura, veshje të pista ose të papërshtatshme
- Kërcënon, ulëret, ose kontrollon sjelljen e kujdestarit
- Sjellja nga plaku që imiton demencën, të tilla si lëkundja, thithja, ose flet me vete
- Depression, konfuzion, përgjumësi
- Shenja abuzimi seksual si: Mavijosje, nxirje rreth gjinjëve ose organeve gjenitale, sëmundje vaginale,ose analale e pashpjegueshme, Të brendëshme, me njolla ose me gjak, veshtirësi në ecje, qëndrimin ulur,

Shenjat paralajmëruese të shfrytëzimit financiar:

- Tërheqje të rëndësishme nga llogaritë e të moshuarit
- Ndryshime të papritura në gjendjen financiare të moshuarit
- Sende, ose të holla të munguara nga familja e të moshuarve
- Ndryshime të dyshimta të vullnetit, autorizimet, tituj pronësie të moshuarit
- Shtimi i emrave në kartën e kredit të moshuarit
- Aktiviteti financiar i lartë që nuk mund të jetë ndërmarrë nga i moshuari, siç është tërheqja nga një ATM kur mbajtësi i llogarisë është i shtruar në spital, ose qëndron në shtrat
- Firma të panjohura në tërheqjen e parave, dokumentave, etj
- Blerje, marrje shërbime të panevojshme, në mallra, ose abonime, etj



NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT



Faktorët e rrezikut për abuzimin me të moshuarit

Është e vështirë të kujdesesh për një të moshuar që ka shumë nevoja të ndryshme dhe është e vështirë të jesh i moshuar kur mosha sjell me vete dobësi dhe varësi. Të dy kërkesat e kujdestarisë dhe nevojat e më të moshuarit mund të krijojnë situata në të cilat abuzimi ka më shumë gjasa të ndodhë.

Faktorët e rrezikut që mund të rrisin potencialin për abuzimin e një personi të moshuar mund të identifikohen në nivel **individual**, **marrëdhëniesh**, **komuniteti** dhe **socio-kulturore**.

Individual

Rreziqet në nivel individual përfshijnë **shëndet të dobët fizik** dhe **mendor** të viktimës, çrregullime mendore dhe **alkooli dhe abuzimi i substancave**. Faktorë të tjerë të nivelit individual që mund të rrisin rrezikun e abuzimit përfshijnë **gjininë** e viktimës dhe një **situatë të përbashkët të jetesës**.

Ndërsa burrat e moshuar kanë të njëjtin rrezik të abuzimit si gratë, në disa kultura ku gratë kanë status të ulët shoqëror, gratë e moshuara janë në rrezik më të lartë të neglizhencës dhe abuzimit financiar (si marrja e pronës së tyre) kur janë të ndara, ose kanë humbur bashkëshortin. Gratë gjithashtu mund të jenë në rrezik më të lartë të formave më të vazhdueshme dhe të rënda të abuzimit dhe lëndimit.

NGRINI ZËRIN TUAJ.

**NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT**



Marrëdhëniet


Një situatë e përbashkët e jetesës është një faktor rreziku për abuzimin e të moshuarve. Nuk është ende e qartë nëse bashkëshortët, ose fëmijët e rritur të të moshuarve kanë më shumë gjasa të kryejnë abuzime. Varësia e një abuzuesi nga personi më i vjetër (shpesh financiare) gjithashtu rrit rrezikun e abuzimit. Në disa raste, një histori e gjatë e marrëdhënieve të varfra familjare mund të përkeqësohet si pasojë e stresit kur personi më i vjetër bëhet më i varur nga kujdesi. Përfundimisht, sa më shumë gra hyjnë në fuqinë punëtore dhe kanë më pak kohë rezervë, kujdesi për të afërmit e moshuar bëhet një barrë më e madhe, duke rritur rrezikun e abuzimit.

Komuniteti

Izolimi social i kujdestarëve dhe personave të moshuar, si dhe mungesa e mbështetjes sociale, është një faktor i rëndësishëm rreziku për abuzimin e pleqve nga kujdestarët. Shumë njerëz të moshuar janë të izoluar për shkak të humbjes së kapacitetit fizik, apo mendor, ose përmes humbjes së miqve dhe anëtarëve të familjes.

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT



Socio-kulturore

Faktorët socio-kulturore që mund të ndikojnë në rrezikun e abuzimit të moshuar përfshijnë:

- Stereotipet e plakjes ku të rriturit më të vjetër përshkruhen si të dobët, të brishtë dhe të varur;
- Mosfeksionimi i lidhjeve ndërmjet gjeneratave të një familjeje;
- Sistemet e trashëgimisë dhe të drejtave të pronësisë, që ndikojnë në shpërndarjen e energjisë dhe mallrave materiale brenda familjeje;
- Migrimi i çifteve të reja, duke lënë vetëm prindërit më të vjetër në shoqëri ku njerëzit e moshuar tradicionalisht përkujdeseshin nga pasardhësit e tyre;
- Mungesa e fondeve për të paguar për kujdesin.

Mosha dhe shëndeti

Qëndrimet negative lidhur me plakjen dhe të moshuarit gjithashtu kanë pasoja të rëndësishme për shëndetin fizik dhe mendor tyre. Njerëzit e moshuar që mendojnë se janë barrë e perceptojnë jetën e tyre për të qenë më pak të vlefshëm, duke i vënë ata në rrezik depresioni dhe izolimi social.

NGRINI ZËRIN TUAJ.
NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Studimet e publikuara kohët e fundit tregojnë se njerëzit më të moshuar që kanë pikëpamje negative për plakjen e tyre, nuk shërohen nga aftësia e kufizuar dhe jetojnë mesatarisht 7.5 vjet më pak se njerëzit me qëndrime pozitive.



Pse Abuzimi të moshuarve mbetet një problem "i padukshëm"?

Ashtu si format e tjera të dhunës ndërpersonale, abuzimi me të moshuarit zakonisht ndodh prapa dyerve të mbyllura. Shumë të moshuar që përjetojnë abuzime ngurojnë të raportojnë abuzimin, sepse ata mund:

- Të ndjehen të turpëruar dhe të ndrojtur, veçanërisht nëse një anëtar i familjes është abuzuesi
- Frikë se abuzuesi do të shqetësohet
- Shqetësohen se do të detyrohen të jetojnë në një shtëpi pleqsh - dhe kjo ndonjëherë ndodh
- Ndjehen fajtor ose ngurrojnë të fajësojnë
- Nuk e kuptojnë se abuzimi po ndodh, ose nuk dinë se ajo që po përjetojnë është abuzim ose neglizhim
- Kanë frikë se në qoftë se raportojnë, abuzimi do të përkeqësohet.
- Disa të moshuar që përjetojnë abuzime mund të mos jenë në gjendje të flasin për shkak të demencave, ose dëmtimeve të tjera.

Ka gjithashtu indikacione se një kulturë e moshimit (paragjykimet ndaj plakjes) dhe frika nga mosha e vjetër mund t'i mbajë njerëzit e moshuar të margjinalizuar dhe nënvlerësuar në shoqëri, prandaj shumë probleme në këto mosha mbeten të padukshme, ose konsiderohen si të parëndësishme.

NGRINI ZËRIN TUAJ.
NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT



Të moshuarit në Shqipëri

Shqipëria është një nga vendet e fundit në Europë që po përjeton efektet e moshimit të popullatës. Proporcioni i popullatës mbi 65 vjeç u rrit nga 5% në 1990, në 11% në censusin e fundit (INSTAT-2011) dhe vijon të rritet. Ka më shumë se 370 000 persona mbi 65 vjeç në vend, krahasuar me rreth 230 000 në vitin 2001.

Sipas INSTAT 2014, tre janë faktorët kryesor të plakjes së popullsisë:

1. **Lindshmëria;** e cila në vendin tonë nga 3,1 fëmijë për grua në vitin 1989, ka zbritur në 1.4 fëmijë për grua. Shqiptarët mbi 60 vjeç në vitin 2017 ishin 93 mijë më shumë në numër se në vitin 2011 kur u bë Censusi i fundit. Kjo grupmoshë tani zë rreth 19% të krejt totalit të popullsisë nga 15.4% që ishte në vitin 2011.
2. **Vdekshmëria;** e cila shoqërohet me rritjen e jetëgjatësisë dhe si rrjedhim efekti kombinuar i të dy faktorëve, (pra ulja e lindshmërisë dhe rritja e jetëgjatësisë) çon në plakjen e popullsisë. Dhe nga viti 2004 jetëgjatësia ka qenë me 74 vjeç dhe në vitin 2014 ajo ka shkuar në 78 vjeç.

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

3. **Emigracioni** faktor tjetër i rëndësishëm, i cili nuk është duke ndikuar vetëm në forcimin e efektit të shtimit relativ të të moshuarve në shoqëri, por gjithashtu edhe në dobësimin e rrjeteve mbështetëse tradicionale të ofruara nga familjet. Emigrimi i anëtarëve të më të rinj në familje është veçanërisht i lartë në Shqipëri: një në dy familje ka të paktën një anëtar të emigruar brënda, apo jashtë vendit (Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2009).



Sipas LSMS 2012, një studim i INSTAT, rreth 10% e të moshuarve ishin të varfër dhe nuk mund të përballonin standartet bazë të jetesës. Studime të kohëve të fundit (IMIAS International Mobility in Ageing Study) tregojnë nivele relativisht të larta të sëmundjeve kronike, depresionit dhe paaftësisë tek të moshuarit. Si IMIAS ashtu edhe LSMS konfirmojnë se paaftësia, sëmundjet kronike dhe depresioni janë vazhdimisht më të larta tek gratë e moshuara krahasuar me burrat.

Ligji Nr 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në familje”, (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018) mbron edhe të moshuarit nga abuzimi


NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, **të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar**, si dhe të çdo individi, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3, të tij, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje.

Different types of disability among elderly by sex (prevalence in %)



INSTAT: ageing of population: situation of older people in Albania

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Çfar mund të bëjmë që të parandalojmë abuzimin dhe mbrojmë të moshuarit



Dita Botërore e të Moshuarve kërkon të demonstrojë se një përfshirje e të gjitha moshave është vendimtare për të pasur qëndrueshmëri, barazi, mirëqenie dhe zhvillim për të gjithë.

Përdoreni këtë ditë si një mundësi për të folur me fëmijët në jetën tuaj për sfidat me të cilat përballen shumë pleq. Ndhimojini fëmijët të kuptojnë se përkatësia në një komunitet do të thotë që ne të gjithë e shikojmë dhe kujdesemi për njëri-tjetrin. Nëse shikojnë se dikush po dëmton një person të moshuar, është e rëndësishme t'u tregojnë një të rrituri tjetër që ata kanë besim, ashtu siç do të thonin nëse do ta shihnin dikë të dëmtonte një fëmijë tjetër. Kjo nuk është një përrallë. Ky është një qytetar i mirë në komunitetin tonë. Ne duhet t'i mbrojmë ata që nuk mund të jenë në gjendje të mbrojnë veten.

Një prej flamujve kryesorë të abuzimit dhe neglizhimit të moshuarit, është izolimi social. Konsideroni të vizitoni anëtarët e komunitetit tuaj të cilët janë të izoluar, që jetojnë vetëm ose që janë zhvendosur në një institucion të kujdesit. Përgatisni për to një gjellë, ëmbëlsirë, ose shkoni me to për çaj ose kafe. Vetëm kalimi i kohës me anëtarët e komunitetit më të vjetër, ose me aftësi të kufizuara mund të bëjë një ndryshim të vërtetë.

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Ju mund të jeni i vetmi person që i keni hedhur sytë mbi ta ose keni ofruar dashamirësi dhe komunikim për ta për një kohë shumë të gjatë. Ofroni transport për të moshuarit.

Bisedoni me to. Pyesni: Çfarë kanë nevojë? A i dëmton dikush? A paguhen faturat e tyre? A marrin shërbimet e tyre? A ka ushqim në frigoriferin e tyre? A kanë marrë barnat e tyre? Nëse ka probleme, që ju nuk mund ti zgjidhni vetë, mund të telefononi Shërbimet e Mbrojtjes Sociale në mënyrë që një punonjës social të ofrojë shërbime dhe zgjidhje.

Inkurajoni personat e moshuar të bëhen pjesë e aktiviteteve të ndryshme që kërkojnë kontakte me të tjerët, të zhvillojnë një rrjet të mbështetjes sociale. Njerëzit e moshuar duhet të kenë kontakt të përditshëm me familjen, miqtë ose fqinjët.

Mësoni faktet rreth abuzimit me të moshuarit. Nëse e dini ose dyshoni se një person i moshuar është abuzuar, neglizhuar ose nuk është duke marrë kujdesin e duhur, raportoni në institucionet përkatëse që merren me parandalimin e abuzimit të këtyre personave.

Shërbimi fillon në shtëpi! Mendoni për mënyrat që ju mund t'i nderoni prindërit tuaj, gjyshërit apo anëtarët e familjes më të vjetër ose me aftësi të kufizuara. Nuk e di se çfarë të bëni? Pyetni! Ndonjëherë vetëm të kesh një person të pyesësh nëse ka ndonjë gjë që ata kanë nevojë mund të bëjë të gjitha ndryshimet

NGRINI ZËRIN TUAJ.

NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT

Si ti respektojmë të moshuarit?

1. Dëgjoni këshillat, mendimet e tyre.
2. Dëgjoni vërejtjet që na bëjnë
3. U bëni dhurata në përvjetorët e lindjes.
4. I ndihmoni kur kanë nevojë për diçka (të blejnë, t'u sjellim ndonjë gjë, ti shoqërojmë diku. etj.).
5. U lëshoni vendin në autobus, në park dhe kudo.
6. I lejoni në radhë para vetes, kur ata duan të blejnë diçka.
7. U kërkoni këshilla, kur duam të bëjmë diçka.

Të moshuarit janë si një libër histori e hapur. Ata tregojnë kohën që kaloi, historinë e familjes, vlerat e kombit, ngjarje të rëndësishme, jetën e vendit në 100 vjet.



Atë që i bën të etë, Ta presësh nga yt bir edhe ti. – N. Frashëri

Nderoje pleqërinë! Ajo është e ardhmja jote!

**DITA NDËRKOMBËTARE PËR NDËRGJEGJËSIMIN MBI
ABUZIMIN ME TË MOSHUARIT 15 QERSHOR 2019**

**NGRINI ZËRIN TUAJ.
NDËRTONI MBËSHTETJE TË FORTË PËR TË
MOSHUARIT**



**UNIVERSITETI ALDENT.
FAKULTETI SHKENCAVE MJEKESORE TEKNIKE,
QENDRA PROMOCIONIT TË SHËNDETIT
PUNOI DR.SH NEDIME CEKA**

BURIMET E PËRDORURA

- World elder abuse awareness day 15 june-the United Nations
- WHO elder abuse
- Raporti kombetar mbi strategjine rajonale te zbatimit (Regional - Implementation Strategy RIS) te Planit Nderkombetar te Madridit per Moshimin (the Madrid International Plan of Action on Ageing -MIPAA) ne Shqiperi gjate periudhes 2012-16
- Perel-Levin S. Discussing Screening for Elder Abuse at Primary Health Care Level. Geneva, Swtzerland: World Health Organization; 2008
- INSTAT Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri Nëntor 2015



**WORLD ELDER ABUSE
AWARENESS DAY**

Building Strong Support for Elders

Lifting Up Voices 2019